



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

01.07.2019

<Emri i Autoritetit Kontraktues> Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga UD z. Daut Reqica në vazhdim (permendet) Autoriteti kontraktues

dhe

<Emri i Kontraktuesit> NTSH "Inline Engineering"-Prishtinë të cilin e përfaqson Valon Hasani , në vazhdim do të përdoret ("Kontraktuesi")

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS : Ndriçimi i parqeve në qytetin e Lipjanit

Numri i identifikimit 613 019 050 521

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës është - Lënda e kësaj Kontrate ka të bëjë me **Ndriçimi i parqeve në qytetin e Lipjanit** , behet Blerja, montimi dhe lidhja e kuadros shpërndarëse elektrike të ndriqimit KESHN te ngjashëm me tipin KRO-RJ(A) prodh.TEP me mbrojtje IP65 i ndërtuar nga Poliesteri me dim : 1200x800x300 mm, me mbyllje hermetike te kapakut dhe me qelës. Kuadri vendoset në bazamentin prej betoni MB20 të përgatitur konform normave teknike. Pajisja që montohet në kuadër duhet të jetë nga materiali që nuk ndryshket kurse të gjitha lidhjet të mbrohen nga korozioni.Kuadri duhet të përmbajë sipas skicës njëpolare të paraqitur në projekt këto elemente:

1. Njehsorin elektrik trefazor digjital të tipit MT174-D2A44-MK0Z i paisur me nderrues tarifor 3x230/400V: 50Hz I miratuar nga MTI
2. Ndërprerës automatik, 3P, magneto-termik, Tip DPX 100-63A
4. Siguresat automatike katërpolare 32A ; - " " " 16A ; - " " " 6A
5. Kontaktorët për kyçje automatike të ndriqimit C-44 ,40A,380V
6. Releun digjital astrologjik për aktivizimin automatik te ndriqimit
7. Voltmetrin për kontrollimin e vlerës së tensionit në faza
8. Paket ndërpresin për kapërcim të tregimit të voltmetrit në faza

9. Prizën njëpolare për shërbime e servise brenda kuadrit

10. Llambën ndiquese në brendi të kuadrit

11. Zbarrat prej bakri për lidhjen dhe përforcimin e përçuesve në faza, zbarren e përçuesve të zeros dhe zbarren e përtokzimit,

12. Shkarkuesit katodik dhe zbarren për barazimin e potencialit. 13. Siguresat thikore 63A, 3 copë;

Të gjithë elementet elektrik duke përfshirë dhe ormanët distributiv duhet të jenë të ndërtuar sipas normave teknike CE dhe IEC. Komplet kuadri shpërndarës elektrik i ndriqimit KESHN deri të shtylla më e afërt. Lidhja e elemnteve duhet te behet ne baze te skemes njekahore e kuadrit shperndares, Ndërtimi i bazamentit të betonit për KKSH të ndriqimit me dimensione 80x90x30cm etj, sipas paramasave dhe parallogarive në dosjen e tenderit me nr ref. 613 019 050 521

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i punëve do të jepet në ofertën financiare (shembulli në pjesen V te kontratës). Çmimi total i kontratës 9851.97 €. Me fjalë (Nëntmije e tetëqind e pesëdhjet e një /euro/e nëntëdhjet e shtatë/centë)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për punët që i ekzekuton në teren

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta (Nenet prej 26 deri 28).

Neni 3 Radhitja e dokumenteve te kontratës sipas prioritetit

Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas prioritetit:

- marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta, duke përfshirë edhe aneksin teknik;
- tenderi i Kontraktuesit;
- oferta financiare (Aneks III);
- Kushtet e Përgjithshme;

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose shmangjes, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe/ose Zyrtarit të Prokurimit, nga njëra anë, dhe Kontraktuesit nga ana

tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit, dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht sipas nenit 4 në Kushtet e Veçanta.

E hartuar në gjuhën [shqipe] në tri origjinale dhe përbëhet prej 16 faqe, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Daut Reqica	Emri:	Valon Hasani
Pozita:	UD	Pozita:	Menagjer
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.07.2019	Data:	01.07.2019

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

1. Përkufizimet

“**Kontrata**” do të thotë marrëveshje në mes të Autoritetit kontraktues (Punëdhënësit) dhe Operatorit Ekonomik (Kontraktuesit), me të cilën Kontraktori obligohet të kryejë punët e kontraktuara, ndërsa Punëdhënësi obligohet të paguajë shumën sipas marrëveshjes.

“**Punë**” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat punëdhënësi kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

“**Punëdhënësi**” është autoriteti kontraktues i caktuar në formën e kontratës, i cili është palë në kontratë dhe duhet ta pranojë punën e mbaruar, për të cilën ai do të paguajë shumën sipas kontratës.

“**Kontraktuesi**” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

“**Kontakt personi**” është njeriu i caktuar në formularin e kontratës, i cili është i autorizuar nga punëdhënësi të mbajë kontakte me Kontraktuesin.

“**Menaxheri i Projektit**” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Punëdhënësi), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Punëdhënësit.

“**Grupi i operatorëve ekonomik**” është asociacion i personave fizikë dhe juridikë apo një grupi të bashkuar, që kanë bërë marrëveshje për kryerjen e punës në tërësi apo një a më shumë pjesësh të punëve të caktuara.

“Tenderi i Kontraktuesit” është dokumentacioni i plotë i dorëzuar si përgjigje ndaj ftesës së autoritetit kontraktues për tender brenda afatit kohor të saktësuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit.

“Specifikacioni” do të thotë specifikime (përshkrime) teknike të punëve të përfshira në kontratë si dhe të gjitha ndryshimet e bëra apo shtesat e miratuara nga punëdhënësi.

“Çmimi Kontratës” do të thotë shuma sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

“Vendi i ndërtimit” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

“Ditët” janë ditët kalendarike

“Pajisjet e kontraktuesit” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

“Skicat” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga punëdhënësi për kryerjen e punëve të kontraktuara.

“Defekte” janë pjesët e papërfunduara të punëve e që është dashur të kryhen sipas kontratës.

“Ndodhitë e zhdëmtuara” janë ato që janë përkufizuar në nenin 21 të këtyre kushteve të përgjithshme të kontratës.

“Forca madhore” është ngjarje apo rrethanë që e ka bërë të pamundur realizimin ose përmbushjen e kontratës nga ndonjëra palë, që ka ndodhur pa fajin e palëve në kontratë dhe që nuk ka mundë të parashikohet a parandalohet.

2. Gjuha dhe Ligji i aplikueshëm

2.1 Kushtet e veçanta e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e procedurës.

3. Komunikimi

- a. Komunikimi ndërmjet palëve kontraktuese do të bëhet me shkrim, në mënyrë elektronike: përmes e-mailit, faksit etj.
- b. Komunikimi lidhur me njoftimin mbi ndërprerjen, ndryshimin, pezullimin apo përmbushjen e kontratës nëse jepen përmes e-mailit apo faksit, patjetër duhet të konfirmohet edhe me shkrim.
- c. Komunikimi me shkrim konsiderohet se është fuqizuar vetëm kur të jetë nënshkruar nga pala kontraktuese që e ka pranuar.
- d. Komunikimi duhet të bëhet shpejt, pa pengesa dhe pa ndonjë vonesë.

4. Sigurimi i vend ndërtimit

4.1 Menaxheri i Projektit me urdhër të punëdhënësit do të kërkojë nga kontraktuesi të bëjë sigurimin e vend ndërtimit me rastin e fillimit të punëve të kontraktuara për shkak të rrezikshmërisë së tyre në rastet si në vijim:

- a. Kontraktuesi është i obliguar të bëjë sigurimin e vend ndërtimit, duke pasur parasysh faktin se për kryerjen e punëve mund të përdoren pajisje të rënda si: eskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të kategorive të ndryshme pastaj skele të larta etj.

- b. Kontraktuesi duhet që me kohë t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar vend ndërtimin në mënyrë që të mos vijë deri te shkaktimi i dëmit kalimtarëve të rastit, objekteve për rreth, komunikacionit etj.
 - c. Kontraktuesi është përgjegjës në çdo rast të shkaktimit të lëndimit trupor dhe/ose shkaktimit të vdekjes si të vet personelit të tij ashtu edhe të palëve të treta si dhe në rast të shkaktimit të dëmit në pronat apo objektet për rreth.
- 4.2 Kontraktuesi do të ofrojë sigurimin në shumën e caktuar për të kompensuar humbjen apo dëmtimin në rast se kjo ndodh gjatë kryerjes së punëve dhe brenda afatit të caktuar kohor për kryerjen e punëve duke llogaritur që nga dita e fillimit të punëve e deri në ditën e përfundimit të tyre. Rastet për të cilat kërkohet kompensimi janë si në vijim:
- a. humbja apo dëmtimi i vend ndërtimit, pajisjeve, materialeve;
 - b. lëndimi trupor, dëmtimi i shëndetit, vdekja e punëtorit apo personit të tretë;
 - c. dëmtimi i objektit, pronës apo pasurisë së personave të tretë;
- 4.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas pranimit të njoftimit për dhënie të kontratës duhet t'i dërgojë menaxherit të projektit polisën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.
- 4.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.
- 4.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, punëdhënësi mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

5. Programi

- 5.1 Brenda kohës së specifikuar në kontratë, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim, në të cilin do të paraqesë mënyrën e rregullt të kryerjes së punëve dhe metodat e përgjithshme që do të zbatohen, renditjen e aktivitetëve të punëve në baza prioriteti, dhe do të llogarisë kohën për secilin aktivitet të specifikuar gjatë përfundimit të punëve të kontraktuara.
- 5.2 Nëse inxhinieri për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit.
- 5.3 Për çdo pakënaqësi apo mospajtim rreth modifikimit të programit, kontraktuesi duhet që këto t'ia argumentojë me shkrim Menaxherit të projektit.
- 5.4 Paraqitja e një programi të tillë të përfshirë me ndonjë plotësim nga ana e Menaxherit të Projektit nuk do të zvogëlojë apo shtojë obligimet e kontraktuesit sikur se as ndonjë modifikim i përfshirë në programin e punës, nuk do të ndikojnë në pagesa shtesë të kontraktuesit, në qoftë se kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhimit të kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

6. Inspektimi dhe testimi

- 6.1 Menaxheri i projektit do të mbikëqyrë kontraktuesin gjatë tërë kohës sa zgjasin punimet duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në përfundimin e projektit përkatësisht ekzekutimin e kontratës.
- 6.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve.
- 6.3 Cilësia e materialeve kontrollohet dhe vlerësohet me anë të testimit të materialeve.

- 6.4 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit ose personi i autorizuar i tij në pajtim me kontraktuesin.
- 6.5 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do ti sigurojë kontraktuesi.
- 6.6 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim.
- 6.7 Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit.
- 6.8 Në qoftë se pas testimit, kontraktuesi konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuar, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

7. Korrigjimi i defekteve

- a. Në rast se menaxheri i projektit vëren ndonjë defekt gjatë kryerjes së punëve menjëherë sa më shpejt që është e mundur dhe pa humbur kohë do të kërkojë me shkrim nga kontraktuesi eliminimin e defekteve.
- b. Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga menaxheri i projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.
- c. Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.
- d. Punëdhënësi do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

8. Informimi në kohë

- 8.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë në kualitetin e punës më vonë.
- 8.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.
- 8.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bërë të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.
- 8.4 Në qoftë se paraqiten punë urgjente dhe të paparapara, kontraktuesi do të ndërmarrë menjëherë të gjitha masat e mundshme për ekzekutimin e atyre punëve edhe pa pëlqimin me shkrim të punëdhënësit dhe sa më shpejt që të jetë e mundur të informojë menaxherin e projektit. Punët e paparashikuara dhe shumë urgjente konsiderohen ato punë që, nëse nuk ekzekutohen menjëherë do të ndikojnë negativisht në kualitetin e punëve të kontraktuara dhe gjithashtu do të rezultojnë me dështim të projektit në tërësi, si p.sh. punët që mbrojnë nga jostabiliteti i objektit ose që mbrojnë nga shkaktimi i dëmeve për shkak të ngjarjeve të pazakonshme dhe të papritura (rrëshqitja e dheut, paraqitja e papritur e ujërave etj).
- 8.5 Nëse kryerja e punëve urgjente dhe të paparapara do të shkaktojë shpenzime shtesë për kontraktorin, kjo gjithsesi do të rezultojë në rritjen e çmimit të kontraktuar, konform dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik.

9. Forca madhore

9.1 **"Force madhore"** siç përdoret këtu mendohet në veprimet e fuqisë mbi natyrore, çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

9.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton forcën madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen.

Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e punëmarrësit do të pezullohen deri në nivelin e pamundësisë së përmbytjes së tyre dhe për aq kohë deri sa pamundësia vazhdon.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton forcën madhore, Menaxheri i Projektit të punëdhënësit duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që punëdhënësi ta paguajë punëmarrësin.
- iv. Afati për përmbytje mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit, mirëpo në kushtet e kontratës duhet të jetë paraparë që afati për përfundimin e punëve të jetë i ndryshëm nga periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se punëmarrësi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë tërësisht apo pjesërisht për shkak të forcës madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, punëdhënësi brenda shtatë (7) ditë mund ta njoftojë me shkrim punëmarrësin për ndërprerjen e kontratës.

10. Lirimi nga përmbytja e kontratës

10.1 Nëse paraqitet çfarëdo rrethane që pamundëson përmbytjen e kontratës dhe ajo rrethanë paraqitet pa fajin e punëdhënësit dhe të punëmarrësit si pasojë e personave të tretë, Menaxheri i Projektit me vendim të punëmarrësit do të ndërpresë vazhdimin e kryerjes së punëve sa më shpejt që është e mundur, do të bëjë vlerësimin e punëve të përfunduara, do të kërkojë nga punëmarrësi të braktisë vend punimin duke e lënë atë në gjendje të rregullt.

10.2 Menaxheri i Projektit do t'i paguajë punëmarrësit për punën e përfunduar deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim mbi ndërprerjen e çdo aktiviteti që ka të bëjë me punët e kontraktuara.

11. Grupi i operatorëve ekonomik

11.1 Në qoftë se grupi i operatorëve ekonomik kanë lidhur marrëveshjen për kryerjen e një apo disa pjesëve të punëve, të gjithë së bashku obligohen t'i kryejnë punët e kontraktuara.

11.2 Grupi i operatorëve ekonomik duhet që me marrëveshjen e tyre të caktojnë një operator ekonomik që të përfaqësojë tërë grupin para autoritetit kontraktues.

11.3 Të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës.

12. Sigurimi për përmbytje të kontratës

12.1 Kontraktuesi do të sigurojë që t'i ushtrojë të drejtat dhe detyrat e tij si dhe përgjegjësitë që dalin nga ato në përputhje me kushtet e caktuara si në kontratë.

- 12.2 Kontraktuesi do të sigurojë se punët do të fillojnë dhe përfundojnë në afatin e caktuar në kontratë, në mënyrë profesionale dhe në përputhje me rregullat dhe standardet teknike që zbatohen në inxhinieri për punë të ngjashme.
- 12.3 Kontraktuesi siguron se të gjitha punët që do t'i kryejë si dhe përmirësimin e defekteve gjatë kryerjes së punëve do ta bëjë në kohë dhe në mënyrë profesionale nga punonjësit profesionalë të kualifikuar.
- 12.4 Kontraktuesi do të sigurojë për cilësinë e punëve dhe për kualitetin e materialeve që përdoren për kryerjen e punëve të kontraktuara.
- 12.5 Kontraktuesi do të paguajë sigurimin për përmbushje të kontratës në shumën e caktuar si dhe deri në afatin e caktuar të kërkuar si në dosjen e tenderit.

13. Tatimi

- 13.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e vendit në të cilin gjendet vend ndërtimi.
- 13.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.
- 13.3 Punëdhënësi do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.
- 13.4 Punëdhënësi nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

14. Humbjet teknike dhe/ose materiale

- 14.1 Të gjitha humbjet, prishjet apo dëmet që shkaktohen në pajisje makinerie dhe në materialin ndërtimor kompensohen nga kontraktuesi, përveç në rastet kur kjo ka ndodhur me fajin e punëdhënësit

15. Përmbushja e Kontratës në afatin e caktuar

- b. Kontraktuesi duhet të fillojë aktivitetin për kryerjen e punëve të kontraktuara në ditën e fillimit dhe t'i përfundojë ato në afatin e caktuar për përmbushje të kontratës.
- c. Kontraktuesi është i autorizuar që t'i kryejë punët në përputhje me projektin kryesor i cili është bazë e projektit ideor.
- d. Në qoftë se kontraktuesi nuk i kryen punët në përputhje të plotë me projektin kryesor ose substancialisht i kryen punët ndryshe nga projekti kryesor, do të përgjigjet për përmbushje të parregullt të kontratës dhe/ose për kundërvajtje ekonomike.

16. Zgjatja e afatit për përmbushje të kontratës

- 16.1 Menaxheri i projektit të punëdhënësit, në bashkëpunim me punëdhënësin do të lejojë zgjatjen e afatit të përmbushjes së kontratës në qoftë se paraqiten punë urgjente dhe të paparapara ose rrethana tjera të cilat pamundësojnë kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar.

17. Penalitetet për të metat

- a. Kontraktuesi do t'i paguajë punëdhënësit për çdo ditë vonese duke llogaritur nga data e caktuar në kontratë për përfundimin e punëve e deri në ditën kur kontraktuesi njofton me shkrim menaxherin e projektit për përfundimin e punëve.
- b. Shuma totale e penaltiteve për të metat nuk mund të tejkalojë totalin e shumës së përcaktuar në kontratë.
- c. Pagesa e penaltiteve nuk do të ndikojë në obligimet e kontraktuesit.

18. Vonesat e ekzekutimit

- 18.1 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë/realizoj ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, punëdhënësi, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.
- 18.2 Nëse mosdorëzimi/realizimi i punëve parandalon përdorimin e zakonshëm të punëve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 18.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës.
- 18.3 Nëse Punëdhënësi ka fituar të drejtën të kërkojë së paku [10 %] të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Kontraktuesin:
 - të konfiskojë garancinë e realizimit;
 - të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
 - të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të punëve. Kontraktuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Kontraktuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

19. Shkëputja e kontratës

- 19.1 Kontrata mund të shkëputet me vullnetin e njërës palë kontraktuese për shkak të shkeljeve materiale të kontratës, në rastet si në vijim:
 - (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit të punëdhënësit;
 - (b) Menaxheri i projektit urdhëron pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune;
 - (c) Palë tjetër kontraktuese falimenton apo hyn në likuidim, përveç më përjashtim të rastit të riorganizimit apo shkrirjes;
 - (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga punëdhënësi brenda 30 ditësh nga dita kur është vërtetuar pagesa në fjalë;
 - (e) Menaxheri i projektit në njoftimin me shkrim që i bënë punëmarrësit mbi evitimin e defekteve, e njofton edhe mbi atë se mos evitimi i defekteve paraqet shkelje bazë të kontratës, megjithatë punëmarrësi nuk ndërmerr masat e nevojshme paraprake për evitimin e defekteve, kështu që dështon në korrigjimin e defekteve brenda 30 ditë pune që përcaktohet nga menaxheri i projektit të Punëdhënësit;
 - (f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e defekteve mund të paguhet;

- 19.2 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje materiale të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me klauzolën 10.1, Menaxheri Projektues do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.
- 19.3 Kur punëdhënësi i paraqet shkresë përkatësisht vendim mbi shkëputjen e kontratës, me këtë kontraktuesi obligohet që brenda 15 ditë pune duke llogaritur nga data e marrjes së vendimit mbi shkëputjen e kontratës, ta pastrojë vend ndërtimin nga mbeturinat eventuale që janë paraqitur gjatë kryerjes së punës, ta sigurojë vend ndërtimin dhe të largohet.

20. Pagesa pas shkëputjes së kontratës

- 19.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera.
- 19.2 Penalitetet për te metat nuk futen në vlerësim;
- 19.3 Nëse shuma totale e borxhit të punëdhënësit tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj punëdhënësit.
- 19.4 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale bazë të kontratës, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë punët e përfunduara gjer në momentin e ndërprerjes së kontratës, materialet e porositura, pagesën e punëtorëve për kryerjen e punëve të kontraktuara, koston e sigurimit të vend ndërtimit me minus pagesat në avans të marra para datës së marrjes së vendimit mbi shkëputjen e kontratës.

21. Ndryshimi në sasi të punëve të përfunduara

- 21.1 Në qoftë se pas llogaritjes së punëve të përfunduara, Menaxheri i Projektit vëren ndryshime në mes të sasisë së punëve të përfunduara dhe sasisë së punëve të kontraktuara për shkak të paraqitjes së rrethanave apo punëve urgjente të paparapara, atëherë do të rregulloj situatën në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.
- 21.1 Nëse sasia e punëve të përfunduara dallon nga sasia në faturën e sasisë për pozicion të veçantë për më tepër se 25%, paraqitet ndryshim që e tejkalon 1% të vlerës të përgjithshme të kontratës pranohe vetëm me miratim të menaxherit të kontratës, ndërsa nëse kemi ndryshime me të mëdha do të merret miratimi nga ZKA dhe nga drejtoria e prokurimit deri në vlerën 10% të vlerës të përgjithshme të kontratës.

22. Shkaqet për kompensim

22.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Punëdhënësi nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit dhe kjo e pengon kontraktuesin që të fillojë punën në afatin e kontraktuar.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.

- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, që atëherë është gjetur se ka të meta.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose punëdhënësi shkaktajnë vonesë apo shpenzime shtesë për punëmarrësin.
- (e) Pagesa në avans vonohet përveç në rastet kur kjo është shkaktuar me fajin e kontraktuesit.
- (f) Menaxheri i projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa rrjedhin si pasojë e jo profesionalizmit të kontraktuesit.

22.2 Nëse ndodh vetëm një apo të gjitha ngjarjet e lartcekura, çmimi do të rregullohet drejt.

23. Vërtetimet e pagesës

- 23.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.
- 23.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.
- 23.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.
- 23.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

24. Zhdëmtimi gjatë kohës së kryerjes së punëve

Humbjet në pajisje, dëmtimi i punëve të kryera, humbja apo prishja e materialit ndërtimor, etj që mund të ndodhin gjatë kryerjes së punëve brenda afatit të kontraktuar mund të shkaktojnë shpenzime të cilat duhet t'i bartë kontraktuesi, përveç në rastet kur kjo ndodh me fajin e punëdhënësit ose/dhe me fajin e Menaxherit të projektit.

25. Gjoritet administrative dhe financiare

- 25.1 Në qoftë se kontraktuesi gjatë periudhës kohore të caktuar për përmbushjen e kontratës, deklarohet se ka përfunduar 50% të punëve të kontraktuara dhe menaxheri i Projektit të punëdhënësit konstaton se ai ka përfunduar më pak se 50% të punëve të kontraktuara, ose në qoftë se kontraktuesi ka përdorur materialin e cilësisë së dobët, jo të kualitetit të specifikuar, menaxheri i Projektit do ta informojë me shkrim menjëherë punëdhënësin.
- 25.2 Për çfarëdo mashtrimesh apo deklaratash të rrejshme të tjera nga ato të përcaktuara paraprakisht me nën-dispozitën 25.1, Menaxheri i projektit menjëherë do ta informojë me shkrim Punëdhënësin.
- 25.3 Në qoftë se konstatohet se kontraktuesi është fajtor për shkak të deklaratave të rrejshme dhe mashtrimeve, nuk do të ketë të drejtë në ekzekutimin e kontratës dhe do të përjashtohet për 10 vite nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit.
- 25.4 Kontraktuesi do të gjoritet financiarisht dhe do të përjashtohet për tri vite nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit në qoftë se nuk e përmbush kontratën.

26. Pranim-Dorëzimi

- a. Pasi që të kryhen të gjitha punët e kontraktuara, bëhet pranim dorëzimi i punëve.

- b. Në procesin e pranim-dorëzimit marrin pjesë palët kontraktuese dhe/ose përfaqësuesit e tyre si dhe projekt menaxherët e emëruar nga punëdhënësi dhe kontraktuesi.
- c. Pranimin teknik do ta bëjnë komisioni i përbërë nga përfaqësuesit e palëve kontraktuese.
- d. Gjatë pranimin teknik do të përpilohet procesverbali në të cilin do të përshkruhet gjendja faktike nëse çdo gjë është punuar në përputhje me kontratën, ose do të konstatojnë të metat dhe parregullsitë nëse ekzistojnë si dhe do të caktojnë afatin për mënjanimin e tyre.
- e. Nëse komisioni konstaton se nuk ka të meta, atëherë lëshohet vërtetimi ose certifikatë mbi përfundimin e punëve.
- f. Punët e kontraktuara nuk do të konsiderohen të përfunduara për derisa Certifikata mbi përfundimin e punëve nuk është nënshkruar nga Menaxheri i Projektit dhe nuk i është dorëzuar kontraktuesit.

27. Llogaritja përfundimtare

- 27.1 Pas përfundimit të punëve, kontraktuesi do t'i dorëzojë punëdhënësit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët e përfunduara si në kontratë.
- 27.2 Menaxheri i projektit nuk do të urdhërojë pagesën sipas llogarisë së punëdhënësit në qoftë se vëren të meta në punën e përfunduar dhe do ta urdhërojë kontraktuesin t'i mënjanojë ato të meta.
- 27.3 Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh duke llogaritur nga data e dorëzimit llogarisë, do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme.
- 27.4 Menaxheri i projektit do të vendosë për shumat e pagueshme për punëmarrësin dhe do të lëshojë certifikatën mbi pagesën.

28. Pagesat

- 28.1 Pagesat do të harmonizohen për zbritjet për pagesat në avans.
- 28.2 Punëdhënësi do t'i paguajë kontraktuesit shumat e vërtetuara nga Menaxheri i Projektit brenda 28 ditësh nga data e vërtetimit të së cilës.
- 28.3 Nëse punëdhënësi bie në vonesë, atëherë kontraktuesit do ti paguhet edhe kamata për çdo ditë vonese në pagesën e ardhshme, e rregulluar sipas bankave vendore për kredi në ndërtimtar.
- 28.4 Artikujt apo sasi të punëve për të cilat asnjë përqindje apo çmim nuk ka qenë e regjistruar nuk do të paguhet nga punëdhënësi dhe vlerësohet se janë mbuluar me çmimin fillestar të kontratës.

29. Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

- 29.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda [15] ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet

për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë [30] ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes [shëno institucionin]. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda [30] ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

30. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda [30] ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë në pajtim me Kushtet e veçanta të kësaj kontrate mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) ose vendim arbitrimi;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet /Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jete gjuha shqipe,
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat]
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 30 dite kalendarike prej hapjes se ditarit te punes

Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është Enver Elshani- Drejtoria e Sherbimeve Publike
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nënshkrimit të kontratës, dhe përfundimi i të gjitha punëve do të jetë 30 dite kalendarike prej hapjes së ditarit të punës. Me fillimin e punëve do hapet ditarit i punës dhe në terren duhet të jetë çdo herë inxhinieri i cili do të nënshkruan ditarin së bashku me menaxherin e caktuar nga autoriteti kontraktues dhe çdo vonesë pa arsye më gjat se plani dinamik i ofertuar do të konsiderohet shkelje e kontratës dhe do të zbatohen penalet.
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periodha garantuere e defekteve është 10% të vlerës së kontratës (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) në afat 1 vjeçar pas pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantuere do të sanojë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompenzim. Në të kundërtën pajtohet se AK ato dëme do të sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të fakturojë Kontraktorit që ka dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Në rast të konzorciumit kjo deklaratë ipet në emër të liderit të konzorciumit
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vendit të punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë ; <i>për të gjitha të metat që paraqiten, të kontraktuesi me fajin e tij do të paguaj nga 0.5% në ditë.</i> Nëse vonohet në përmbushjen e kryerjes së punëve sipas planit dinamik gjithashtu do të zbatohet kjo përqindje. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Çmimi i kontratës	20	Çmimi i punëve shprehur në shifra 9851.97 €. Me fjalë (Nëntmijë e tetëqind e pesëdhjet e një /euro/e nëntëdhjet e shtatë/centë)
Parapagimi	20.1	Shuma e Parapagimit është: <i>nuk ka avans</i> €
Pagesa	20.2	Pagesat do të bëhen: sipas situacioneve të përfunduara në terren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës deri sa të arrijn shumën 90% të kontratës , ndërsa pjesa e mbetur prej 10% do t'i paguhet pas pranimit teknik të punëve.
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është:

Siguria ekzekutimit	e	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vleres së kontrates. Kontraktuesi do të paguaj shumën prej 985.20€ , me rastin e nënshkrimit të kontratës për 60 dite, nëse nuk ka vërejtje gjatë kësaj kohe në punët e kryera, kontraktuesit do t'i kthehet siguri i ekzekutimit ,në të kundërtën nëse kontraktuesi dështon në përfundimin e punëve apo nëse paraqiten vërejtje gjatë kohës së sigurimit , siguri i ekzekutimit do të konfiskohetn .
Shkëputja kontratës	e	23	Kontrata mund të shkëputet me vullnetin e njëres palë kontraktuese për shkak të shkeljeve materiale të kontratës, në rastet si në vijim: Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit të punëdhënësit; Menaxheri i projektit urdhëron pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; Pala tjetër kontraktuese falimenton apo hyn në likuidim, përveç me përjashtim të rastit të riorganizimit apo shkrirjes; Menaxheri i projektit në njoftimin me shkrim që i bënë punëmarrësit mbi evitimin e defekteve, e njofton edhe mbi atë se mos evitimi i defekteve paraqet shkelje bazë të kontratës, megjithatë punëmarrësi nuk ndërmerr masat e nevojshme paraprake për evitimin e defekteve, kështu që dështon në korrigjimin e defekteve brenda 30 ditë pune që përcaktohet nga menaxheri i projektit të Punëdhënësit; Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e defekteve mund të paguhet; Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje materiale të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me klauzolën 10.1, Menaxheri Projektues do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës. Kur punëdhënësi i paraqet shkresë përkatësisht vendim mbi shkëputjen e kontratës, me këtë kontraktuesi obligohet që brenda 15 ditë pune duke llogaritur nga data e marrjes së vendimit mbi shkëputjen e kontratës, ta pastrojë vend ndërtimin nga mbeturinat eventuale që janë paraqitur gjatë kryerjes së punës, ta sigurojë vend ndërtimin dhe të largohet.

20. Pagesa pas shkëputjes së kontratës	24	Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera Penalltit për te metat nuk futen në vlerësim; Nëse shuma totale e borxhit të punëdhënësit tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj punëdhënësit. Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale bazë të kontratës, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë punët e përfunduara gjer në momentin e ndërprerjes së kontratës, materialet e porositura, pagesën e punëtorëve për kryerjen e punëve të kontraktuara, koston e sigurimit të vend ndërtimit me minus pagesat në avans të marra para datës së marrjes së vendimit mbi shkëputjen e kontratës.
2Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Palët Kontraktuese pajtohen që kontestet eventuale që lindin me rastin e dispozitave të kësaj kontrate të zgjedhin me marrëveshje. Afati për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve palët kontraktuese pajtohen që të jetë 15 ditë nga dita e paraqitjes së kontestit nga ana e palës do t'i dorëzohen për arbitrim <specifiko organin për zgjidhje të mosmarrëveshjeve > në inicuesë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <u>gjykatën Supreme e Kosovës</u> në pajtim me ligjin në Kosovë.

PJESA II. PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Ndriçimi i parqeve në qytetin e Lipjanit

Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe te standardeve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender. OE është i obliguar që t'i sjell edhe certifikatat e garancionit për pasijet në fjalë të cilat paisje duhet të jenë plotësisht të njëjta me të dhënat teknike të përshkruara në katalogje apo broshura, po ashtu duhet të sjellë edhe certifikaten e origjinës së materialeve. Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet tja prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim.

Nr	Lloji i materialit i nevojshëm për kryerjen e punëve elektroinstaluese	Njesia	Sasia	Qmimi njësi	Gjithsej me TVSH
1	Blerja, montimi dhe lidhja e kuadros shpërndarëse elektrike të ndriçimit KESHN te ngjashëm me tipin KRO-RJ(A) prodh. TEP me mbrojtje IP65 i ndërtuar nga Poliesteri me dim : 1200x800x300 mm, me mbyllje hermetike te kapakut dhe me qelës. Kuadri vendoset në bazamentin prej betoni MB20 të përgatitur konform normave teknike. Pajisja që montohet në kuadër duhet të jetë nga materiali që nuk ndryshket kurse të gjitha lidhjet të mbrohen nga korozyoni. Kuadri duhet të përmbajë sipas skicës njëpolare të paraqitur në projekt këto elemente: 1. Njehsorin elektrik trefazor digjital të tipit MT174-D2A44-MK0Z i paisur me nderrues tarifar 3x230/400V: 50Hz i miratuar nga MTI 2. Ndërprerës automatik, 3P, magneto-termik, Tip DPX 100-63A 4. Siguresat automatike katërpolare 32A ; - " " " 16A ; - " " " 6A 5. Kontaktorët për kyçje automatike të ndriçimit C-44 ,40A,380V 6. Releun digjital astrologjik për aktivizimin automatik te ndriçimit 7. Voltmetrin për kontrollimin e vlerës së tensionit në faza 8. Paket ndërpresin për kapërcim të tregimit të voltmetrit në faza 9. Prizën njëpolare për shërbime e servise brenda kuadrit 10. Llambën ndiquese në brendi të kuadrit 11. Zbarrat prej bakri për lidhjen dhe përforcimin e përçuesve në faza, zbarrën e përçuesve të zeros dhe zbarrën e përtokzimit, 12. Shkarkuesit katodik dhe zbarrën për barazimin e potencialit. 13. Siguresat thikore 63A, 3 copë; Të gjithë elementet elektrik duke përfshirë dhe ormanët distributiv duhet të jenë të ndërtuar sipas normave teknike CE dhe IEC. Komplet kuadri shpërndarës elektrik i ndriçimit KESHN deri të shtylla më e afërt. Lidhja e elemnteve duhet te behet ne baze te skemes njekahore e kuadrit shperndares.	copë	2.00	350.0	700.00
2	Ndërtimi i bazamentit të betonit për KKSH të ndriçimit me dimensione 80x90x30cm	m³	0.43	60.0	25.92
3	Betonimi i bazamentit të shtyllave (40x40x75)cm për 31 shtylla (0.4x0.4x0.75x31)m³ me beton të tipit MB30	m³	3.72	65.0	241.80
4	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te galvanizuara konike të cilat realizohen me mbjellje, komplet me araldit, perqes NYY-J 3x2.5 mm² ,qypi pvc ku mbjelllet shtylla si dhe siguresa, lartesia e shtyllave te jete 3.5m mbi tokë se bashku me trupen ndriquese e specifikuar si ne situacion,shtyllat duhet te jene te prodhuara sipas standardeve EN40,të galvanizuara sipas BS EN1461:1999	copë	31.00	95.0	2,945.00

5	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED 30W. E ndërtuar nga aliazhe alumini, e fortë, e vrazhdë, rezistent ndaj gërvishjeve dhe goditjeve me mbyllje silikone. Tensioni: 90-264V (50 - 60Hz) Color temperature: 6000K Efikasiteti i ndriçueshmerisë: 3000 lm Jetëgjatësia: 50000 orë, Këndi i montimit 120/15 shkallë, Mbrojta nga lagështia: IP65 Mbrojta mekanike: IK10 Klasa e sigurisë: I Temperatura: -30 deri +60 grad celsius Shpërndarja e dritës: Asimetrike . Certifikimi: CE, C-tick, RoHS, PSE, ISO90012008 Poashtu drita duhet të plotësoj EN60598 - 1:2008 dhe EN60598 - 2 - 3:2003 Garancioni: 5 vite.		copë	31.00	35.0	1,085.00
6	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese Spot LED 12W për ndriçimin e drunjëve të parqeve dhe kopshteve e fiksuar përmes sondes së mbjellur me gjatësi 60cm si në detajet. E ndërtuar nga aliazhe alumini me mbyllje silikone e rezistueshme ndaj nxehtësis dhe e mbuluar me PMMA, Tensioni: 110 - 270V (50 - 60Hz) Color temperature: Light Warm White(3200K) White(6000K) Efikasiteti i ndriçueshmerisë: 1200 lm Jetëgjatësia: 100000 orë Mbrojta nga lagështia: IP66 Mbrojta mekanike: IK10 Klasa e sigurisë: I Temperatura: -30 deri +60 grad celsius EN60598 - 2 - 3:2003 Garancioni: 5 vite		copë	37.00	35.0	1,295.00
7	Furnizimi dhe vendosja e kabllor furnizuese NAYY- 4x25mm ² për ndriçim publik prej shtyllave elektrike deri te KKSHN	m	180.00	2.5	450.00	
8	Furnizimi dhe vendosja e kabllor për furnizimin e trupave ndriçuese NAYY (Al) 4x16mm ² prej KKSHN	m	935.00	1.2	1,122.00	
9	Mihja e kanalit të gjatë 830m për shtrirjen e kabllor tokësor me dimensione 75x50cm si dhe mbulimi me rrastim i kanalit bëhet me makinat përkatëse.	m ³	311.25	1.0	311.25	
10	Furnizimi dhe vendosja e shiritit për tokzim Fe/Zn 25*4mm	m	450.00	1.0	450.00	
11	Furnizimi dhe vendosja e gypit PVC FI 60 për kabllor furnizuese	m	1000.00	0.5	500.00	
12	Matja e tokzimit mbrojtës dhe dhënja e atestit të tokzimit	copë	1.00	50.0	50.00	
13	Montimi i kabllorve në shtyllat e tensionit elektrik	copë	2.00	50.0	100.00	
14	Shqyrtimet e nevojshme të kabllorve dhe tokzimit nga një kompani e licencuar për këtë.	copë	1.00	50.0	50.00	
15	Porositja , furnizimi transporti dhe shtrirja e shiritit paralajmerues "RREZIK TENSIONI" përgjatë gjatësisë së kanalit.	m	810.00	0.1	81	
16	Sonda pertokezuese Ø75mm/1500mm	copë	6.00	5.0	30	

17	Porositja, furnizimi transporti dhe shtrirja e e rërës se imet në kanalin me dimensione (0.5x0.75)cm dhe me gjatesi 830m ne nivelin 20 cm.	m ³	83.00	5.0	415
24	TOTALI 1				9,851.97 €